



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. _____ Prot

Datë 20/05/2024

PROCES VERBAL

**Konsultimi për Draft Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta
Urbane 2024-2029**

Vendi : Qendra Kulturore Multifunkionale, Përmet

Ora : 11:00

Tema e konsultimit : Draft Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta 2024-2029.

I mbajtur sot më datë 20 Maj në sallën e konferencës pranë Qendrës Kulturore Multifunkionale. Të pranishëm në këtë takim janë : Eksperti z.Konals Gjoka, Specialisti i Shërbimeve Publike z.Arian Jaupi, Kryetar I Këshillit Bashkiak zj.Anila Dhimitri, Sekretar I Këshillit Bashkiak z.Aleks Tane dhe disa anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Takimin e hapi z.Gjoka, i cili është ekspert i fushës së menaxhimit të mbetjeve urbane. Ai tregoi se ne hartimin e këtij plani, një ndihmë të konsiderueshme ka dhënë stafi i Bashkisë Përmet të cilin e falenderoi për përkushtimin dhe angazhimin e dhënë.

Më pas ai vijoi me prezantimin e draft planit duke thënë se ai bazohet tek indikatorët e performancës për të qenë sa më efikas. Plani do të shtrihet në një periudhë 5 vjeçare veprimi. Eksperti shtoi se duhet angazhim maksimal nga të gjithë aktorët për të aritur rezultate. Gjithashtu ai tregoi se prioritetet e këtij plani janë :

1. Zonat urbane të mbulohën 100% me shërbim
2. Zonat rurale të mbulohen deri në 90% me shërbim
3. Mbetjet të jenë të ndara sipas llojit

Ai vijoi duke u treguar të pranishmëve se ky shërbim do të shoqërohet me një rritje të tarifës. Gjithashtu eksperti shpjegoi se mbetjet e grumbulluara do të peshohen në stacionet e grumbullimit dhe më pas do të selektohen për kompostim.

Të pranishmit në sallë shfaqën mjaft kënaqësi lidhur me këtë plan duke e vlerësuar pozitivisht.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Në fund të prezantimit eksperti z.Konals Gjoka falenderoi të pranishmit dhe gjithashtu shprehu mirënjohje për këdo që ka kontribuar në hartimin e këtij plani.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Foto nga takimi:

